REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 893-894 /20
Datë/Datum. 18.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi			
Gjemajli Bellanica;	08.11.2020	18.11.2020	893/20 894/20
	Data e autorizimit të ekspertit	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.11.2020 dhe 06.11.2020 OE "SHKËMBI-GLLAREVË" Shpk – Klinë & OE N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë kan parashtruar ankesë me nr: 893/20 dhe 894/20 kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit,lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndertimi i urës në rrugën nacionale N9, segmenti Pejë- Kuqishtë lokacioni Drelaj**" , me nr. të prokurimit: **205-20-3973-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Punë, vlera e parashikuar e kontratës: **400 000.00 €**.

Data e njoftimit për kontratë.....27.07.2020.
Data e hapjes së ofertës.....28.08.2020.
Data e njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit.....21.10.2020.
Data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm.....21.10.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim .....26.10.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:.....28.10.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE "SHKËMBI-GLLAREVË" Shpk – Klinë & OE N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë

Dispozitat e shkelura

Neni 1 - Qëllimi;
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 - Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi;
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës;
Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit;
Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;
Neni 44.5 i RROUP;

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet OE "SHKËMBI-GLLAREVË" Shpk – Klinë

Të nderuar, ne me dt.21.10.2020 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin se *"Edhe pas sqarimeve nuk ka prezantuar marrëveshjet me qira të paisjeve të noterizuara në mes qiradhënësit dhe qiramarrësit sipas kërkesës"*, ndërsa e keni anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se të gjitha ofertat janë të papërgjegjshme.

Ju sqarojmë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron për faktin, se ne në ofertë i kemi prezantuar marrëveshjet konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj arsyeja e AK-së për eliminimin tonë nuk qëndron.

Gjithashtu ne edhe pas sqarimeve shtesë të kërkuara nga ana e AK-së i kemi prezantuar përsëri marrëveshjet me qira të pajisjeve, të cilat marrëveshje janë konform kërkesës së FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj duke u bazuar në këtë fakt shihet qartë se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe nuk është dashur të eliminohemi nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se ne i përmbushim të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, andaj është dashur të shpallemi si tenderues i përgjegjshëm.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë kërkojmë nga ju që të detyroni AK që të rishqyrtoj njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe që të analizoj në detaje secilin dokument tonin të ofruar dhe të vijnë në përfundime të sakta dhe të drejta në lidhje me ofertën tonë sepse shumë qartë kuptohet dhe vërtetohet se ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

AK-ja në këtë rast nuk i ka zbatuar dhe nuk i ka përdorur drejt dispozitat e nenit 72 të LPP-së, pasi që nuk i keni marrë parasysh sqarimet tona të detajizuara dhe të konfirmuara nga ana jonë.

Pra duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se AK-ja e ka anuluar pa bazë këtë aktivitet të prokurimit dhe në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Ne me dt. 28.10.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.
Arsyetimi i AK-së në lidhje me refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim nuk qëndron për faktin se ashtu siç e kemi cekur në kërkesën për rishqyrtim po e cekmi edhe një herë se ne e kemi plotësuar kërkesën e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë sepse i kemi prezantuar marrëveshjet origjinale të nënshkruara nga marrësi dhe qiradhënësi për paisjet me qira, të cilat janë konform kërkesës në dosjen e tenderit. Ndërsa sa për korrektësi po ju bashkangjesim edhe një herë origjinalin e marrëveshjes të cilin e kemi prezantuar edhe me rastin e ofertimit.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura dhe në arsyen e refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim shihet qartë se AK-ja nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona, mirëpo ka dhënë arsyen e njëjtë sikurse në arsyen e eliminimit edhe tani në vendimin për refuzim të kërkesës tonë për rishqyrtim.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 i LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të

LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, pasi që tenderit jonë ka qenë në përputhje me aspektet përmbajtjesorë të tenderit, mirëpo AK-ja nuk na ka rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu ky anulim i këtij aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë.

Me këtë vendim autoriteti kontraktues na ka diskriminuar neve në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*".

Gjithashtu AK-ja nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 6 të LPP-së ku është e cekur qartë se *"Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit"*.

AK-ja është dashur ta ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, ankesa e OE **"SHKËMBI-GLLAREVË" SH.P.K** si e bazuar
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në
RIVLERËSIM,
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet OE N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë

Te ndernar, ne me dt. 21.10.2020 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se, ku jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin se *"Nuk i kemi plotesuar kerkesat tek kapaciteti teknik pika 5. Lista e mjeteve, stabi/imenteve dhe pajisjeve teknike qe Jane te domosdoshme per realizimin e projektil sipas specifrkimit teknik ne dosje te tenderit"*, ndersa AK-ja e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin se te gjitha ofetat janë të papërgjegjshme.

Fillimisht ju sqarojme se AK-ja me dt. 31.08.2020 na ka derguar letren standarde per sqarim te tenderit, ku e ka cekur se: Juve ju mungon lista e pajisjeve te aneksit 1, ju lutem ta plotesoni listen me paisjet te cilat i keni te prezantuara ne E prokurim per kete projekt dhe te bashkengjitni deshmite per paisjet te renditura sipas listes se bashkangjitur ne Aneksin 1. Gjithashtu deshmite duhet te jene te dukshme.

Ndersa ne me dt. 01.09.2020 e kemi kthyer pergjigjen ne lidhje me kerkesen e AK-se ku e kemi sqaruar se: Ne makinerine tone e kemi prezantuar ne listat e makinerise se secilit anetar te konzorciumit te nenshkruar dhe te vulosur, kemi bashkangjitur edhe deshmite perkatese per secilen paisje sipas kerkeses se dosjes se tenderit.

Per shkak te numrit te madh te makinerise qe kemi ne dispozicion dhe qe tejkalojme kerkesat e AK-se per kete tender, ne po ju prezantojme edhe nje here vetem nje pjese te makinerive ne Aneksin 1 PAISJET DHE MEKANIZMI I OBLIGUESHEM, ngase ne si konzorcium kemi ne posedim makineri me shume se sa kerkesat e AK-se te lartpermendur, per projektin e lartpermendur). Pergjigjes ne kerkesen per sqarime i kemi bashkangjitur edhe: Listen e paisjeve dhe mekanizmi i obligueshem dhe deslunite rreth pronesise se paisjeve (Lista e makinerise te nenshkruar dhe vulosur, librezen e regjistrirnit valid, fature,DUD ose kontratat noteriale te shitblejes, kontrate per qiramanje noteriale etj).

Perseri AK me dt.16.09.2020 na ka derguar letren standarde per sqarim te tenderit, ku ka kerkuar te ju dergojme kontratat me paramase per projektet e meposhtme:

1. Kanalizimi atmosferik dhe riasfaltimi i rruges Astrit Bytyqi, data e nenshkrimit te kontrates 17.08.2017: date e nenshkrimit te kontrates 17.08.2017, ndersa vlera e kontrates 246,499.55 euro.
2. Kanalizimi atmosferik dhe riasfaltimi i rruges Astrit Bytyqi faza e dyte, data e nenshkrimit te kontrates 14.12.2016: date e nenshkrimit te kontrates 13.08.2018, ndersa vlera e kontrates 289,484.55 euro.

Ne me dt.18.09.2020 i kemi kthyer pergjigje AK-se ku e kemi cekur se: Ne ju sqarojme se kemi ofruar kontrata, procesverbale te pranimeve teknike dhe referenca te mjaftueshme konform kerkeses se dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate nga AK: MI. Deshmite e ofruara nga ne e tejkalojne

dyfishin e kerkuar nga ana juaj ne dosje te tenderit per projektin e lartpermendur dhe se edhe pa keto dy kontrata qe i keni kerkuar sqarimet shtese ne i plotesojme kushtet per te qene te pergjegjshem. Megjithate ne po ju ofrojme sqarimet shtese ne lidle me kontratat e kerkuara, ku i kemi prezantuar deshmite e kerkuara (kontratat me paramase, pranimet tekni ke, referencat).

Po ashtu AK-ja perseri me dt.12.10 .2020 na ka kerkuar sqarime shtese per sqarimin e tenderit ku ka kerkuar nga ne te bejme sqarimin e tenderit tone si ne vijim: Ne dosjen e tenderit tek kapaciteti teknik eshte kerkuar pika 5. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe paj isjeve teknike qe jane te domosdoshme per realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1 . Deshmia 5 Pajisjet te cilat regjistrohen duhet te deshmohen me librezen e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndersa pajisje tjera, OE duhet ti deshmoj me nje dokument per pronesine e pajisjeve (fature, DUD etj).

Eshte kerkuar pika 1 Eskavator, kapaciteti min. (0.4-1)m3, ndersa ju keni prezantuar Eskavator Komatsu me peshe 15000 kg, Liebher me peshe 22000 kg, Caterpilar me peshe 22700 kg, komatsu 23500 kg, komatsu 18000 kg.

Eshte kerkuar pika 3 Ngarkues, kapaciteti min.(1-1.5) m3, ndersa ju keni prezantuar Ngarkues Thomas me peshe 3600 kg, Zettelmeyer me peshe 22000 kg, Liebher me peshe 30000 kg, Cat me peshe 14000 kg, Liebher me peshe 8500 kg, O&K me peshe 10000 kg. Per pilen 1 dhe piken 3,ju lutem te prezantoni deshmi per kapacitetin e pajisjeve te kthyera ne m3, per arsye qe ne DUD nuk jane te prezantuara kapaciteti ne m3.

Eshte kerkuar pi ka 2 Kamion kapaciteti min. (10-12) m3 kiper, ndersa ju keni prezantuar kamion kiper 05-410-CQ, 07-359-BQ, 07-461-CT.
Ne librezat e prezantuara nuk figuron kapaciteti i kamioneve. Ju lutem te deshmoni kapacitetin e kamionave te cekur me lartë

Eshte kerkuar pika 13 Cilinder me rrota hekuri me vibrim min. 3t ndersa ne dud doganor nuk ceket lloji i rrotave te hekurit.
Ju lutem te prezantoni deshmi qe Cilindrat e prezantuar nga ana juaj jane me rrota hekuri.

Ndersa ne me dt.16.10.2020 ju kemi derguar pergjigjen ne lidhje me sqarimet e kerkuara ku ne e kemi cekur se: Ne si kompani ju sqarojme se kemi ofruar makineri te mjaftueslune per kete projekt konfonn kerkesave te kerkuara nga ana juaj.Gjithashtu ne sqarimet shtese qe ju kemi derguar me dt.01.09.2020, ne perseri ju kemi derguar makinerite te specifikuara per secilen tek lista e mjeteve, stabilimenteve dhe paisjeve teknike, te cilat jane te domosdoshme per realizimin e projektit dhe kemi cekur se ne listen e prezantuar ne kemi prezantua vetem nje pjese te makinerise qe kemi ofrua ngase ne listat e makinerise te anetareve te konzorciumit kemi ofruar shume me shume makineri se sa qe keni kerkuar ne dosje te tenderit.

Ne ne kete liste kemi dhene detaje te mjaftueslune per llojin e mjetit si dhe kemi ofruar deshmi per secilin si Dud doganor apo fature blerje ose libreze regjistrimi valide. Ne dud/fature/libreze ne menyre te detajuar shkruan lloji i mjetit, pesha e mjetit si dhe numri serik apo numri i shasise.

Andaj ne baze te ketyre te dhenave AK-ja e ka pasur shume lehte qe ti verifikoi preten imet tuaja se ai plotesojne kriteret e kerkuara apojo makineria e prezantuar nga anajone tek lista e mjeteve stabilimenteve dhe paisjeve teknike si dhe ne listat e mjeteve te prezanhiara nga secili anetar i konzorciumit. Ky vertetim ka mundur te behet shume lehte nga ana e AK-se duke kerkuar ne internet (Google) ose direkt ne fabrikat e prodhueseve, ku mjafton te shkruhet numri serik ose i shasise dhe informacionet merren brenda minutave.
Megjithate ne si kompani e pergjegjshme qe jemi ju kemi ofruar deshmi dhe te dhena shtese me pershkrim, katalogje si dhe fotografi te mjeteve te prezantuara nga ne, edhe pse konsiderojme qe ne rapolt me ne AK-ja ka perdorur standarcle te clyfishta dhe te pa nevojshme.
Gjithashtu e kemi cekur se jemi te hapur per bashkepunim ne çfarëdo menyre qe AK-ja kerkon dhe qe eshte ne suaza te ligjit dhe FDT-se dhe dosjes se tenderit.

Mirepo edhe pas te gjitha sqarimeve te ofruara nga anajone vlen te ceket se dy here i kemi ofruar faktet dhe deshmite e kerkuara ne lidhje me paisjet per te cilat keni kerkuar sqarime shtese, AK-ja perseri na ka eliminuar me pretekstin se nuk i plotesojme kerkesat ne lidhje me kapacitetin teknik tek paisjet e kerkuar.
Andaj edhe nje here po ju sqarojme se arsyet e AK-se per eliminimin tone nuk qendrojne per faktet si ne vijim:
Sa i perket pretendimit te AK-se dhe arsyes se eliminimit se ne nuk e plotesojme kerkesen ne lidhie me piken 1 sepse eshte kerkuar Eskavator, kapaciteti min. (0.4-l)m3, ndersa ne kemi prezantuar Eskavator Komatsu 150 ES-6 me peshe 15000 kg me 1.14 1113 me shume se (0.4-1.0)m3;
Liebher 912 LC me peshe 22000 kg, me 0.15-0.48m3 me pak se (0.4-1.O)m3;
Caterpilar 320 me peshe 22700 kg, me 1.14-1.50 m3 me shume se (0.4-l.O)m3;
Komatsu PC228 me peshe 23500 kg, me 0.50-1.2 m3 dhe 0.66-1.57 m3 dhe 0.66-1.571113 me shume se (0.4-l.O)m3;
Komatsu 18000 kg, me l.14m3 me shume se (0.4-l.O)m3;
Liebher A31 OB me 0.15-0 .44m3 me pak se (0.4-1.0) m3, ju sqarojme se ky pretend im i AK-se nuk qendron per faktin se ne i kemi ofruar paisjet ashtu siç eshte kerkuar ne FDT dhe tek njoftimi per kontrate, e keto deshmi mund te vertetohen shume lehte duke i analizuar katalogjet e ofruara nga ne ne lidhje me ekskavatoret e ofruar nga ana jone. Gjithashtu deshmite e ofruara nga ne mund te vertetohen dhe te qartesohen nese kerkohen permes internetit me ane te numrit te shasise ku munf te merren te gjitha informacionet e sakta ne lidhje me ekskavatoret e ofruar nga ne.

Ne katalogjet e ofruara nga ne jane te dhena te gjitha specifikat dhe karakteristikat e eskavatoreve te prezantuar nga ne, ndersa sa i perket luges se eskavatoreve ju sqarojme se ato mund te nderrohen dhe te vendohen me madhesi te ndryshme.

Ne lidhje me piken 3 ku AK-ja e ka cekur se eshte kerkuar Ngarkues, kapaciteti min.(1-1.5) m3, ndersa ju keni prezantuar:
Ngarkues Thomas TZP me peshe 3600kg, ku AK-ja e ka cekur se nuk kemi derguar informacione per kete paisje, per pajisjen Zettelmeyer 1801 me peshe 12000 kg, me 2.0 m3 me shume se (l-l.5)m3 ndersa per pajisjen Liebher L580 me peshe 30000 kg, me 5m3 me shume se (1-1.5) m3, Cat me peshe 14000 kg, ku AK-ja ka theksuar se ne sqarime keni prezantuar Atlas AR95 i cili nuk eshte ne oferte, ndersa per pajisjes O&K me peshe 10000 kg AK -ja e ka cekur se nuk kemi ofruar informacione, ju sqarojme se edhe ky pretendim i AK-se eshte i pabazuar, per faktin se ne ngarkuesin Atlas AR95 e kemi te prezantuar ne listen e anetarit tone te konzorciumit N.N Ndeltimi, prandaj ofrimi i deshmive shtese ne lidhje me kete ngarkues eshte ne perputhje te plotë me nenin 59.2 dhe 72 te LPP-se dhe ne perputhje të plotë me kerkesen e AK-se per sqarime shtese.

Ky arsyetim i AK-se tregon qmte jo seriozitetin e AK-se ne lidhje me vleresimin dhe ekzaminimin e ofertes tone sepse edhe pasi qe ka kerkuar dy here sqarime ne lidhje me paisjet nga ky veprim i AK-se po krijohet pershtypja qe nuk i ka analizuar fare deshmite tona te cilat jane shume te qarta dhe te dukshme ose ne te kunderten AK-ja nuk ka vullnet per ti pranuar deshmite konkrete dhe te cilat jane ne perputhje me kerkesat e FDT-se dhe te njoftimit per kontrate. Pra eshte shume e qarte qe ngarkuesi AR95 ka qene i prezantuar ne liste te OE N .N Ndertimi dhe po ashtu eshte shume e qartë qe deshmia shtese e ofruar nga ne eshte ne perputhje te plotë me kerkesen e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate. Pra ne si OE perveç ngarkuesit Atlas AR95 i kemi edhe deshmite tjera te prezantuara ne dosjes te tenderit, per ngarkuesit tjere siç jane Zettelmeyer, Thomas TZP, Liebher L580, Cat, O&K e te cilet po ashtu jane konfonn kerkeses se dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate.

Sa i perket pikes 2 ku AK-ja e ka cekur se eshte kerkuar Kamion kapaciteti min (10-12)m3 kiper,ndersa ne kemi prezantuar kamion kiper 05-410-CQ, 07-359-BQ, 07-461-CT. Ndersa si arsye per eliminim e ka cekur se ne librezat e prezantuara nuk figuron kapaciteti i kamioneve dhe pas kerkeses per sqarime OE ka prezantuar vetem foto si deshmi, ku me ane te fotove nuk plotesohet kerkesa per sqarim, ne ju sqarojme se edhe ky pretendim i AK-se per eliminimin tone eshte i pa bazuar per faktin se ne në listen e mjeteve kemi dhene detaje te mjaftueshme per llojin e mjetit si dhe kemi ofruar dëshmi per secilin kamion si Dud doganor apo fature blerje ose libreze regjistrim valide. Ne dud/fature/libreze ne menyre te detajuar shkruan lloji i mjetit, pesha e mjetit si dhe numri i serik apo numri i shasise.

Andaj AK-ja ka mund ur shume lehte ti vertetoj deshmite tona ne lidhje me kamionet e ofruar se a i plotesojne kriteret e kerkuara apojo, madje ka mundur te kerkoj edhe ne internet (Google) ose direkt ne fabrikat e prodhueseve, ku mjafton te shkruhet numri serik ose i shasise dhe infomiacionet merren

brenda minutave, mirepo qe edhe nje here po ju sqarojme se nga ky veprim i AK-se po krijohet pershtypja qe nuk i ka analizuar fare deshmite tona te cilat jane shume te qarta dhe te dukshme ose ne te kunderten AK-ja nuk ka vullnet per ti pranuar deshmitë konkrete dhe te cilat jane ne perputhje me kerkesat e FDT-se dhe te njoftimit per kontrate . Pra ne edhe përmes sqarimeve shtese kemi argumentuar faktet dhe deshmite ne lidhje me kamionet dhe per neve eshte e quditshme dhe e habitshme se perse nuk merren parasysh keto deshmi ne lidhje me kamionet nga ana e AK-se.

Duke u bazuar ne te gjitha deshmite dhe faktet qe u ceken me larte kerkojme nga ju qe te detyroni AK qe te rishqyrtoj njoftimin mbi vendimin e AK-se dhe qe te analizoj ne detaje secilin dokument tonin te ofruar dhe te vijne ne perfundime te sakta dhe te drejta ne lidhje me odertën tone sepse shume qartë kuptohet dhe vërtetohet se ne jo vetem qe i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e FDT-se dhe te njoftimit per kontrate, mirepo kemi ofruar edhe me shume paisje dhe stabilimente teknike se sa qe eshte kerkuar ne FDT dhe tek njoftimi per kontrate.

AK-ja ne kete rast nuk i ka zbatuar dhe nuk i ka perdorur drejt dispozitat e nenit 72 te LPP-se, pasi qe nuk i ka marre parasysh sqarimet tona te detajizuara dhe te konfirmuara nga ana jone.
Pra duke i pasur parasysh te gjitha faktet ne lidhje me kronologjine dhe ecurine e ketij aktiviteti te prokurimit, rezulton se AK-ja e ka anuluar pa baze kete aktivitet te prokurimit dhe ne kundershtim me nenin 62 te LPP-se sepse nuk jane permbushur asnjera nga kushtet e parashikuara ne kete dispozite.

Ne me dt. 28.10.2020 kemi marre pergjigje ne kerkesen per rishqyltim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kerkesa per rishqyrtim, mirepo nuk ka dhene asnje pergjigje konkrete dhe ligjore per refuzimin e kerkese tone per rishqyrtim.AK-ja me kete arsyetim te tyre vetem sa i ka vertetuar edhe me shume se pretendimet tona ankimore se jane te bazuara.

Ne lidhje me arsyen e refuzimit te kerkeses tone per rishqyltim nga ana e autoritetit kontraktues,ju sqarojme se ky arsyet im nuk qendron per faktin se AK-ja nuk i ka shqyltuar fare pretendimet tona ankimore par vetem e ka perseritur arsyen e njejte sikurse ne njoftimin mbi vendimin. Andaj duke u bazuar ne kete fakt shihet qartë se AK-ja nuk ka vullnet ashtu siç e kemi cekur edhe me larte per ti pranuar deshmite konkrete dhe te cilat jane ne perputhje te plotë me kerkesat e FDT-se dhe te njoftimit per kontrate.

Ne i kemi prezantuar deslunite tona fillimisht dy here ne kerkesat per sqarime shtese nga ana e AK-se, gjithashtu edhe ne kerkesen per rishqyrtim, mirepo AK -ja nuk po i merr fare parasysh duke dhene disa here te njejten arsye, kjo tregon qalte jo seriozitetin e AK-se ne lidhje me vleresimin dhe ekzaminimin e ofertës tonë. Mirepo nese eventualisht ne nuk do ti permbushnim kerkesat e FDT-se dhe te njoftimit per kontrate, AK-ja do ti kishte sqaruar pretendimet tona dhe do te na vertetonte me fakte se pretendimet tona nuk jane te bazuara.

Andaj duke u bazuar ne faktet e lartëcekura shihet qarte se arsyetimi i AK-se per refuzimin e kerkeses tone per rishqyrtim nuk qendron dhe eshte i pa bazuar dhe gjithashtu shihet qartë se ne jemi OE i cili i përmbush te gjitha kerkesat e FDT-se dhe njeherit jemi dhe OE me i lirë se të gjithë OE e tjerë ofertues.

Pra AK-ja me cydo kusht eshte duke u munduar te na eliminoje ne kete aktivitet te prokurimit pavaresisht fakteve dhe deshmive qe ne i kemi ofruar dhe prezantuar, madje me kerkesat per sqarime qe i kane bere disa here, kane treguar qartë tendencen e tyre per te na eliminuar dhe qartë kane treguar jo seriozitetin ne vleresimin e tendereve.

Duke u bazuar ne deshmite dhe faktet qe u ceken me lartë rezulton se ekzaminimi vleresimi dhe krahasimi i tendereve nuk eshte berë në harmoni me nenin 59 te LPP-se dhe njekohesisht nuk eshte respektuar edhe kriteri kryesor per dhenie te kontrates, e qe ka qene tenderi i pergjegjshem me çmim me te ulet sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-se.

Gjithasht u AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 te LPP-se, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e FTD-se dhe te njoftimit per kontrate. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne menyre te barabartë dhe jo - diskriminuese dhe do te veproje ne menyre transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qe Gjate udheheqjes se aktiviteteve te prokurimit, te gjitha autoritetet kontraktuese do te sigurojne; qe (vi) qe tenderi i zgjedhur te perputhet me te gjitha aspektet permbajtjesore te kushteve, kritereve dhe specifikimeve perkatese, mirepo AK-ja nuk i eshte perrnbajtur as kesaj dispozite ligjore,pasi qe tenderi jone ka qene ne perputhje me aspektet permbajtjesore te tenderit, mirepo AK-ja nuk na ka rekomanduar per kontrate.

Gjithashtu ky anulim i ketij aktiviteti te prokurimit eshte here ne kundershtim edhe me nenin 44.5 te Rregullave dhe Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik (RRUOPP), sepse asnjeri nga kushtet e parashikuara ne keto dispozita nuk jane permbushur ne kete rast dhe nuk ka asnje mundesi ligjore qe ky aktivitet i prokurimit te anulohet ne kete faze.
Me kete vendim autoriteti kontraktues na ka diskriminuar neve ne kundershtim me nenin 7 te LPP-se, ndersa ne paragrafin 1 te nenit 7 te LPP-se parashihet qa lle *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne menyre te barabarte dhe Jo- diskriminuese dhe do te veprojë ne menyre transparente"*

Gjithashtu AK-ja nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 6 te LPP-se ku eshte e cekur qartë se "Te gjitha autoritetet kontraktuese, Jane te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te perdoren ne menyren me ekonomike, njekohesisht duke marre ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimit".

AK-ja eshte dashur ta kete ne konsiderate edhe nenin 1 te LPP-se, pasi qe dihet se qellimi i ketij ligji eshte te siguroje menyren me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike,

burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove.

Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe deshmite qe u ceken me larte, kerkojme nga OSHP-ja qe te merr:

VENDIM

APROVOHET, ankesa e OE "N.N.SH.WORLD MEDIUM" si e bazuar
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-se per anulirnin e aktivitetit te prokurimit dhe lencla kthehet ne RIVLERESIM,
DETYROHET autoriteti kontraktues qe gjate rivleresimit, ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit, njoftimit per kontrate dhe konform dispozitave te LPP-se.

Nese nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojme proceduren ligjore ne institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

Çertifikata e regjistrimit të biznesit(numri fiskal)

Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore)

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1. OE duhet te ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjate 3 viteve te fundit ka qene ne vlere, se bashku ne te tri vitet, prej jo me pak se 500,000.00 euro

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. Menaxheri i projektit - Inxhinier i diplomuar I ndërtimtarisë 3 vite përvojë punë pas diplomimit Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy(2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi ,ose ndërtimi i urave).

2. Udhëheqësi i punishtes - Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv - 3 vite përvojë pune pas diplomimit ,si udhëheqës I punishtes në projektet e ndërtimit, apo rikonstruktimit të strukturave në rrugë (urave , nënkalime ose mbikalime) .Së paku 2 projekte si udhëheqës I punishtes në

lëminë e strukturave.

3. Gjeodeti - Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit , ing. i gjodezisë (shkolla e lartë e gjodezisë), me tri vite përvojë pune pas diplomimit ose Baçelor i diplomuar I gjodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit.

4. Inxhinieri i Komunikacionit - Një Inxhinier I diplomuar i komunikacionit rrugor me dy(2) vite përvojë pune pas diplomimit dhe të ketë të realizuar së paku një projekt në lëminë e kërkuar.

5. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1.

6. Lista e kontratave te realizuara perfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se 500,000.00 euro.Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit të rrugëve, ndërtimit të rrugëve, rehabilitimit të rrugëve dhe rikonstruktimit të rrugëve.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

a) Kopja e certifikatës së regjistrimit te biznesit(numri fiskal)
b) Kopja e certifikatës së TVSH-së

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1. Deklaratat Tatimore vjetore te dorëzuara ne ATK për tri vitet e fundit

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. CV-a, Diploma (e noterizuar) ,kontrata e punës me ofertuesin (origjinal ose kopje e noterizuar, duke specifikuar titullin e projektit , për të cilin ka lidhë kontratë.Referencat për punët e mëparshme në lëminë e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit .

2. CV-a, Diploma (e noterizuar), Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Kontrata e punës me punëdhënësin për këtë projekt (origjinal ose kopje e noterizuar).

3. CV- a diploma (e noterizuar),Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Kontratë punës (origjiinal ose e noterizuar) me punëdhënësin duke specifikuar titullin e projektit, për të cilin ka lidhë kontratë.

4. CV- a,diploma (e noterizuar) ,Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. Kontratë punës (origjinal ose e noterizuar) me punëdhënësin duke specifikuar titullin e projektit, për të cilin ka lidhë kontratë.

Vërejtje! 1-4 Nëse Operatori Ekonomik nuk ka ne përbërjen e stafit të tij inxhinierët e lartcekur atëherë mund të angazhoj ata – si dëshmi të prezantoj Kontratë pune ose marrëveshje për pune specifike për bashkëpunim me punëdhënësin duke specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin ne fjale.

5. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë,DUD etj).

Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve.Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

6. Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën,datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar per periudhën e shkuar tre vjeçare.

Autoriteti kontraktues mund të bëjë verifikimin e çdo dokumenti si dhe inspektimine kapaciteteve teknike profesionale të gjithë operatorëve ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit. Nëse operatori ekonomik ka paraqitur të dhëna të rrejshme automatikisht do të eliminohet nga vlerësimi dhe oferta e tij do të konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]
1	N.N.SH. WORLD MEDIUM ; NDËRTIMI ING SH.P.K.; N.N. Ndërtimi ; Rahovica Comerce SH.P.K.,	295918,24 euro
2	SHKËMBI-GLLAREVË SH.P.K.; Bujar Shabani B.I.,	297319,20 euro
3	Grup i Operatorëve Ekonomik INTERING CONSTRUCTION SH.P.K.; K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K.; MEL Engineering	307709,92 euro
4	"SALLAHU" SH.P.K.,	323977,97 euro
5	Benita Company; ASFALT GROUP SH.P.K.,	325893,29 euro
6	ARFA GROUP SH.P.K.; Euroasphalt Sh.p.k.,	329826,40 euro
7	„Lika Trade" Sh.p.k., I	371140,28 euro
8	Eurokod SH.P.K.; Mirusha Company Sh.p.k,	397000,00 euro

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Ministria e Infrakstruktures dhe transportit **anulon**[3] aktivitetin e prokurimit sepse te gjitha ofertat e pranuara janë te pa pergjegjeshem .

Data: 21.10.2020

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "SHKËMBI-GLLAREVË" Shpk – Klinë & OE N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë

Përgjigje në Pretendimin për OE "SHKËMBI-GLLAREVË" Shpk – Klinë

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues thotë që AK e ka eleminuar me arsyetimin qe edhe pas sqarimeve nuk ka prezentuar marrëveshje me qira të paisjeve të noterizuara në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit sipas kërkesës,ndërsa OE ankues pretendon se e ka plotësuar këtë kërkesë konformë FDT-së dhe njoftimit për komtratë.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për kontratë është:" *Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1*" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar : "*Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë,DUD etj)*" Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve.Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Pas analizës së dokumentacionit të ofruar në E prokurim, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka ofruar një marrëveshje për qira të makinerisë e cila është e lidhur në mes të: "N.P. VICTORIA INVEST INTERNATIONAL Sh.P.K" si qiradhënës dhe OE "SHKEMBI-GLLAREVË SH.P.K si qiramarrës. Në këtë marrëveshje bëhet fjalë për makinerinë (MAKIN VINÇ, DUD DOGANOR R7455), e cila përmbanë të dhënat si emërtimi i projektit në fjalë, data e fillimit,kohëzgjatja e marrëveshjes,nënshkrimin dhe është vulosur,ndërsa si dëshmi është ofruar DUD Doganor.Mirëpo eksperti shqytues vlerson që kjo marrëveshje nuk është konform FDT-së dhe njoftimit për kontratë për faktin se në kërkesë thuhet që marrëveshjet duhet të jenë të noterizuar.

Andaj duke pas parasysh kërkesën e FDT-së dhe dëshmit e ofruar nga OE ankues,eksperti shqyrtues vlerson se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar për faktin se marrëveshja e ofruar nuk është e noterizuar, nuk është konformë dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin për OE N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues thotë se arsyeja e eleminimit nga AK-ja është që *nuk i kemi plotesuar kerkesat tek kapaciteti teknik pika 5. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike qe Jane te domosdoshme per realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit,* nuk qëndron për faktin se kemi plotësuar në tërsi kerkesat e DT-së.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për kontratë është:" *Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik ne dosje te tenderit tek Aneksi 1*" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar : "*Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë,DUD etj)*" Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve.Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Në vijim gjeni te bashkangjitur tabelën me pajisje të kërkuar nga AK-ja,sipas Aneksit 1 të Dosjes së tenderit.

IV: PAISJET E NEVOJSHME PËR KËTË PROJEKT:"Ndërtimi i Urës në rrugën N9,lokacioni Drelaj'

Nr:	Përshkrimi i paisjes	Sasia e kërkuar	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhënat për paisjet (viti i prodhimit,gjendja e paisjes,kamiona ,rexh.i targave ,mekanizimi,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë huazimi).
1	Eskavator,kapac. min(0.4-1.0)m^3	2		
2	Kamion kapacitet min(10-12)m3 kiper	4		
3	Ngarkues,kapac.min(1-1.5)m3	2		
4	Cilindër për kompaktimin e tamponit nën themele	1		
5	Paisjet për lakimin e armaturës	1		
6	Automjet të specializuar për bartjen e betonit të gatëshëm	1		
7	Vibrator për beton	1		
8	Çekan Pneumatik/Hidraulik	1		
9	Cisternë për karburante	1		
10	Vinç për bartjen e trajëve të Paranderë me fuqi bartëse prej së paku 30 t	1		

Në pikën 1 të kësaj kërkese është kërkuar 2 (Dy) Eskavator me kapacitet min (0.4-1.0)m3,ndërsa OE ankues për këtë kërkesë ka paraqitur:
Eskavator Kamatsu 150 ES-6 me peshe 15000 kg me 1.14m3 me shume se (0.4-l.O)m3;
Liebher 912 LC me peshe 22000 kg me O. l 5-0.48m3 me pak se (0.4-l.O)m3;
Catepilar 320 me peshe 22700 kg me 1.14-1.50 m3 me shume se (0.4-l.O)m3,
Komatsu PC228 23500 kg me 0.50-1.2 m3 dhe 0.66-l.57m3 me shume se (0.4-1.0)m3,
Komatsu 18000 kg. me l.14m3 me shume se (0.4-l.O)m3;
Liebher A310B me 0.15-0.44m3 me pak se (0.4-l.O)m3;

Lidhur me ketë pretendim eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur nje gamë të madhe të makinerisë për të cilat ka ofruar edhe dëshmi DUD Doganor,mirëpo makinerinë e ofruar nga OE ankues nuk është në përpouthje me kërkesën e FDT-së,ku është kërkuar kapaciteti i eskavatorëve (0.4-1.0)m3,eskavatorët e ofruar disa janë më shumë se kërkesa e disa janë më pak se kërkesa (0.4-1.0)m3.

Andaj pas analizës së dokumentacionit të ofruar në E prokurim,pas krahasimit të makinerisë së ofuar dhe klikimeve në Internet për keto tipe të Eskavatorëve,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues nuk qëndronë për faktin se makineria e ofruar nuk është konformë kërkesës së FDT-së dhe Njoftimit për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

Lidhur me arsyen e eleminimit në pikën 2 të këtyre paisjeve është kërkuar *Kamion me kapacitet min (10-12)m3 kiper,sasia 4 (katër),*ndërsa AK thotë se OE ankues ka ofruar kamion kiper: 05-410-CQ, 07-359-BQ, 07-461-CT.
Ne Librezat e prezantuara nuk figuron kapaciteti i kamioneve dhe pas kerkeses per sqarim OE ka prezantuar vetem foto si deshmi, ku me ane te fotove nuk plotesohet kerkesa per sqarim.

Në vijim gjeni të bashkangjitura listat me kamiona nga të dy anëtarët e konzorciumit:

9	Kamion Kiper	MERCEDES	2644 K 6x4	LIBREZË
10	Kamion Kiper	MERCEDES	2626 AK 6x6	LIBREZË
11	Kamion Kiper + Kran	IVECO	MAGIRUS	LIBREZË
12	Kamion	MAN 26403	HD32A	FATURË
13	Rimorkio, Llobodicë	MYLLER 730		LIBREZË
14	Rimorkio, Llobodicë	STEYR	CONDOR	LIBREZË

Kamionat			
1	Kamion	Mercedes Actros	05-410-CQ
2	Kamion	Mercedes Actros	05-739-CS
3	Kamion	Mercedes Actros	05-941-CC
4	Kamion	Mercedes	05-358-EH
5	Kamion	Mercedes Actros	05-935-DH
6	Kamion	Mercedes Actros	05-384-DM
7	Kamion	Mercedes Actros	05-684-DH
8	Kamion	Mercedes Actros	05-497-EA
9	Rimorko	Kogel	05-405-TA
10	Kamion	Mercedes Benz	05-223-EL
11	Kamion	Steyr	05-162-CR
12	Kamion	Scania	05-732-AU
13	Kamion	MAN TGS 31.360	05-154-EG
14	Kamion	MAN TGS 41.480	05-187-EG
15	Kamion Cisternë AutoBode	Mercedes Benz 2226	05-858-EE
16	Koke Terheqëse	Mercedes Actros 1846	05-247-EL
17	Rimorkio	Schmitz	05-840-XB
18	Rimorkio par bartje te paisjeve	Rimorkio	05-498-TA

AK-ja ka kërkuar sqarime nga OE ankues për kamionët,ndërsa OE ankues ka dhënë përgjigjjen dhe ka paraqitur fotografi për këto tre makineri (05-410-CQ, 07-359-BQ, 07-461-CT),ndërsa kërkesë ka qenë katër kamionë.

Pas analizës së dokumentacionit të ofruar për kamionët nga OE ankues për plotësimin e pikes 2 të Aneksit 1 të DT-së,ku është kërkuar *"Kamion kapacitet min (10-12)m3 kiper sasia 4"*.
Eksperti shyrtues vlerson se OE ankues edhe pse ka prezentuar makineri të shumët për këtë projekt,mirëpo kamionat e prezantuar nga OE ankues nuk janë konformë Aneksit 1 të FDT-së dhe Njoftimit për kontratë,andaj ky pretendim i OE ankues është i pa qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

Operatori ekonomik ankues është eleminuar edhe për pikën 3 të Aneksit 1 të FDT-së,është kërkuar Ngarkues,kapac.min(1-1.5)m3 sasia 2 (Dy).OE ankues pretendon që ka plotësuar në tërsi kërkesën e DT-së ndërsa AK thotë:

Eshte kerkuar pika 3 Ngarkues, kapac. Min (l-1.5)m3, ndersa ju keni prezantuar: Ngarkues Thomas TZP me peshe 3600 kg, nuk ka derguar informacione. Zettelmeyer l80l me peshë 12000 kg, me 2.0m3 me shume se (1-1.5)m3
Liehber L580 me peshe 30000kg, me 5 m3 me shume se (1-1.5)m3 Cat me peshe l 4000kg, ne sqarime keni prezantuar Atlas A R95 i cili nuk eshte ne ofertë.
O&K me peshe 1OOOOkg, nuk ka derguar infonnacione.

Pas analizës së dokumentacionit të ofruar nga OE ankues,lidhur me makinerinë ngarkuese,eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur informacione shtesë për disa ngarkues të kërkuar nga AK-ja,për ngarkuesin Thomson TYP 245 për të cilin AK thotë se nuk ka dhënë informacione OE ,paisja e ofruar posedon deshmi dokumentare DUD Doganor.Për verifikim sa më të mire të paisjes eksperti shqyrtues ka berë kërkim në internet dhe paisja e ofruar nuk është konformë FDT-së.Më poshtë gjeni të bashkangjitur të dhënat për ngarkuesin.

Technical specs - T 245 HDk Thomas

Notice. Every data listed is verified by LECTURA Specs team experts. However, incomplete data and mistakes might occur. Contact our team with any change suggestion.

Weight	3.63 t	Rated operating capacity	1089 kg
Standard tyres	12x16.5	Bucket capacity	0.65 m³
Transport length	3.68 m	Transport width	1.85 m
Transport height	2.12 m	Travel speed	10 km/h
Engine manuf.	Kubota	Engine type	V3300T
Engine power	65 kW	Track width	###
Bucket width	###	Driver protection	###

Sa i përket paisjes të ofruar nga OE ankues Atlas AR 95 për të cilin AK thotë se nuk është në ofertë,sqarojmë se kjo makineri është ofruar nga anëtari i konzorciumit OE "N.N Ndërtimi",po ashtu edhe për këtë paisje është kërkuar në internet dhe paisja e ofruar përmban këto të dhëna. Shih në vijim tabelën.

Technical specs - AR 95 E Super Atlas

Notice: Every data listed is verified by LECTURA Specs team experts. However, incomplete data and mistakes might occur. Contact our team with any change suggestion.

Weight	8.2 t	Standard tyres	15.5-25 EM 20
Bucket width	2.3 m	Bucket capacity	1.6 m³
Bucket capacity min.	1.4 m³	Bucket capacity max.	1.6 m³
Steering mode	KL	Transport length	6.23 m
Transport width	2.18 m	Transport height	2.93 m
Travel speed	20 km/h	Max. discharge height	2.84 m
Turning radius outside	4.61 m	Lifting force	82 kN
Engine manuf.	Deutz	Engine type	TCD4.1 L04
Engine power	95 kW	Displacement	4.004 l

Duke pas parasysh kërkesën sipas Aneksit 1 të FDT-së,ku është kërkuar *Ngarkues,kapac.min(1-1.5)m3 sasia 2 (Dy)*,eksperti shqyrtues vlerson se kjo paisje nuk është konformë DT-së për faktin se kapaciteti i paisjes është min 1.4 m3 – 1.6m3 dhe nuk e plotëson kërkesën e FDT-së.

Për paisjen O&K MH 210 me peshë 1OOOOkg,për të cilën AK thotë se nuk ka derguar informacione.Për këte paisje OE ankues si dëshmi dokumentare ka ofruar DUD Doganor,emertimi i makinerisë në DUD Doganor është Ngarkues me lopatë.Gjatë kërkimit në internet rezulton t'i ketë këto të dhëna.Shih më poshtë tabelën gjatë kërkimit në internet.

Technical specs - MH 2.10 O&K

Notice: Every data listed is verified by LECTURA Specs team experts. However, incomplete data and mistakes might occur. Contact our team with any change suggestion.

Weight	10.6 t	Standard tyres	8.25-20
Bucket capacity	0,33 m³	Engine manuf.	Perkins
Engine type	1004.4	Engine power	54 kW
Bucket capacity min.	###	Bucket capacity max.	###

Sa u përket Ngarkuesve tjerë për të cilët është eleminuar OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se edhe pas sqarimeve te Ofruara nga OE ankues për AK-në dhe pas analizës së dokumentacionit të ofruar,këta ngarkues tejkalojnë kërkesën e Aneksit 1 të FDT-së ku thuhet:*"Ngarkues,kapac.min(1-1.5)m3 sasia 2"*.

Andaj pas sqarimeve të dhëna më lartë për pikën 3 të Aneksit të DT-së,rezulton se paisjet e ofruara nuk janë konformë Kërkesës së FDT-së dhe Njoftimit për kontratë.Rrjedhimisht ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE **"SHKËMBI-GLLAREVË" Shpk – Klinë & OE N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë** të aprovohen pjesërisht si të bazuara, dhe të vërtetohet njoftimi i AK-së për anulimin e aktivitetit. Më tej rekomandohet që nëse AK edhe më tutje ka interes, atëherë mund ta inicioj aktivitetin përsëri.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - **Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit**
Panelit Shqyrtues - OSHP
OE ankues - OE "SHKËMBI-GLLAREVË" Shpk – Klinë & OE N.N.SH "WORLD MEDIUM" Malishevë